

UNIVERSITETI I PRISHTINËS, FAKULTETI I FILOLOGJISË, DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE  
LETËRSISË GJERMANE

# Silabuset e lëndëve

---

Programi Master "Gjuhë dhe Letërsi Gjermane"

## Contents

SEMESTRI I NËNTË.....	3
LËNDËT MËSIMORE – TË OBLIGUESHME .....	3
Silabus i lëndës <i>Semantikë</i> .....	3
Silabus i lëndës <i>Autorë dhe modele (Antologji e veprave nëpër kohë)</i> .....	8
Silabus i lëndës <i>Metodologji e punës shkencore</i> .....	13
LËNDËT MËSIMORE – ME ZGJEDHJE.....	18
Silabus i lëndës <i>Gramatikalizimi</i> .....	18
Silabus i lëndës <i>Gramatika funksionale dhe struktura informative</i> .....	22
Silabus i lëndës <i>Semiotikë</i> .....	26
Silabus i lëndës <i>Autor i zgjedhur 1</i> .....	30
Silabus i lëndës <i>Letërsia bashkëkohore gjermane</i> .....	34
Silabus i lëndës <i>Didaktika e letërsisë</i> .....	38
Silabus i lëndës <i>Metodat në mësimdhënien e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj</i> .....	42
SEMESTRI I DHJETË .....	46
LËNDËT MËSIMORE – TË OBLIGUESHME .....	46
Silabus i lëndës <i>Pragmatikë</i> .....	46
Silabus i lëndës <i>Letërsia e krahasuar</i> .....	51
Silabus për <i>Punimi i Diplomës MA</i> .....	57
LËNDËT MËSIMORE – ME ZGJEDHJE.....	60
Silabus i lëndës <i>Sintaksë gjenerative</i> .....	60
Silabus i lëndës <i>Modelet gramatikore</i> .....	64
Silabus i lëndës <i>Variantet e gjuhës gjermane</i> .....	68
Silabus i lëndës <i>Psikolinguistikë</i> .....	72
Silabus i lëndës <i>Kritikë intermediale</i> .....	76
Silabus i lëndës <i>Autor i zgjedhur 2</i> .....	80
Silabus i lëndës <i>Teoritë letrare</i> .....	84
Silabus për lëndën <i>Didaktizimi i leksikut në mësimdhënien e gjuhës gjermane</i> .....	90
Silabus i lëndës <i>Praktikë e mësimdhënies</i> .....	94

## SEMESTRI I NËNTË

### LËNDËT MËSIMORE – TË OBLIGUESHME

#### Silabus i lëndës *Semantikë*

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Semantikë
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	viti i V-të, semestri i 9-të
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. dr. Teuta Abrashi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:teuta.abrashi@uni-pr.edu">teuta.abrashi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Shprehjet gjuhësore siç është fjalia janë të ndërtuara nga fjalët, të cilat kanë kuptimin apo kuptimet e veta. Semantika jo vetëm që hulumton kuptimin e këtyre fjalëve, ajo duhet të shpjegon se si nga kuptimet individuale të fjalëve ndërtohet kuptimi i njësive me të larta strukturore. Pra, ajo duhet të shpjegon se si vjen deri te kuptimi i fjalisë. Për të arritur një cak të tillë janë zhvilluar mjete dhe metoda, duke u mbështetur në postulatet e logjikës moderne e klasike, për të analizuar dhe pasqyruar kuptimin e thjeshtë dhe të përbërë të shprehjeve gjuhësore. Kjo lëndë ka për qëllim për të njoftuar studentët me parimet themelore të kësaj disipline, si p.sh. relacionet mes kuptimit dhe shprehjes, koncepte dhe fjalët, fusha e fjalës, studimi i rasës:

	interpretimi semantik i gjenitivit, frazat si njesi semantike, fjalia si njesi semantike, relacionet semantike mes fjalive etj.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i njoftojë studentët me parimet themelore të kësaj disipline</li> <li>- t'i vetëdijësojë studentët me relacionet mes kuptimit dhe shprehjes</li> <li>- t'ua mundësojë studentëve të merren me zbatimin e frazave si njesi semantike, fjalia si njesi semantike</li> <li>- t'ua mundësojë studentëve lidhjen midis teorisë dhe praktikës</li> <li>- t'ua mundësojë të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për semantikën e gjuhës gjermane</li> </ul>

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:
	- t'i njoftojë studentët me parimet themelore të kësaj disipline
	- t'i vetëdijësojë studentët me relacionet mes kuptimit dhe shprehjes
	- t'ua mundësojë studentëve të merren me zbatimin e frazave si njesi semantike, fjalia si njesi semantike
	- t'ua mundësojë studentëve lidhjen midis teorisë dhe praktikës
	- t'ua mundësojë të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për semantikën e gjuhës gjermane

<b>Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)</b>			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2 (45 min)	15	22,5
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	3,45
Testi, punimi i seminarit	10	2	20
Detyrë shtëpie	2	15	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45

Përgatitja për provimin final	10	2	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
Total			<b>155,95:25=</b> <b>6.23</b> <b>6 ECTS</b>

**Metodat e mësimdhënies:** Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike. Studentët obligohen ta përgatisin dhe ta prezantojnë një seminar me shkrim nga kjo lëndë.

**Metodat e vlerësimit:** Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.

- Punimi seminarik 30%
- Pjesëmarrja aktive 10%
- Provimi final 60%

**Provimi:** Kusht për provim është punimi seminarik. Provim përmbledhës në afatin e provimeve. Provimi është vetëm me shkrim.

**Literatura primare:**

1. Löbner, Sebastian (2003): Semantik- eine Einführung. Walter de Gruyter, Berlin/ New York
2. Zimmermann, Thomas Ede (2014): Einführung in die Semantik. WBG, Darmstadt
3. Busse, Dietrich (2009): Semantik. UTB, Wilhelm Fink, München
4. Schwarz, Monika/ Jeannette Chur (2014): Semantik- Ein Arbeitsbuch. Narr verlag, Tübingen
5. Adamzik, Kirsten (2010): Sprache: Wege zum Verstehen, 3., überarbeitete Auflage. UTB A. Francke Verlag, Tübingen und Basel
6. Lohnstein, Horst (2011) Formale Semantik und natürliche Sprache, 2., durchgesehene und erweiterte Auflage. Walter de Gruyter, Berlin/ New York
7. Krifka, Manfred (2006): Satzsemantik

**Literatura shtesë:**

1. Busch, A./ Stenschke, O. (2007): Germanistische Linguistik, Tübingen: Narr Franke (S.75-114)
2. Pöring, Ralf/ Ulrich Schmitz (Hrsg.) (2003): Sprache und Sprachwissenschaft- Ein kognitiv orientierte Einführung, Narr Studienbücher, Günther Narr, Verlag, Tübingen
3. Brandt, Patrick/ Rolf-Albert Dietrich/ Georg Schön (2006): Sprachwissenschaft, UTB, Wien
4. Grewndorf/ Hamm/ Sternefeld (1998): Sprachliches Wissen- Eine

- Einführung in die moderne Theorien der grammatischen Beschreibung, Suhrkamp, Frankfurt am Main
5. Duden- Grammatik (2005)Bd.4 Mannheim
  6. Engel U (2004): Deutsche Grammatik, München
  7. Meibauer, J. (et.all) (2002): Einführung in die germanistische Linguistik, Stuttgart: Metzler (S.15-67)
  8. Vater, H. (1996): Einführung in die Sprachwissenschaft, München: Fink (S.68-103)Barthes, Roland (1991). Aventura semiologjike, Prishtinë.

## Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje, fillimi i semantikës, qëllimi i semantikës
Java 2:	Kuptimi dhe semantika, rrafshi i kuptimit (kuptimi i shprehjes, kuptimi i thënies, qëllimi komunikues), kuptimi i fjalisë dhe kompozicionaliteti(kuptimi leksikor dhe kompozicional, kuptimi gramatikor, struktura sintaksore dhe rregullat e kompozicionalitetit, parimi i kompozicionalitetit)
Java 3:	Kuptimi deskriptiv, shoqëror dhe ekspresiv (konceptet, kuptimi përshkrues, kuptimi dhe interaksioni shoqëror apo kuptimi shoqëror, kuptimi dhe subjektiviteti, konotacionet)
Java 4:	Ambiguitetet (Leksemat, ambiguiteti leksikor, ambiguiteti kompozicional, ambiguiteti kontekstual, zhvendosjet kuptimore dhe polisemia)
Java 5:	Kuptimi dhe Logjika I (bazat e logjikës, tiparet logjike të fjalive, relacionet logjike ndërmjet fjalive)
Java 6:	Kuptimi dhe Logjika II (logjika e predikateve, relacionet logjike ndërmjet fjalëve, logjika dhe kuptimi)
Java 7:	Relacionet kuptimore (sinonimia, hiponimia, opozicionet, fushat e fjalëve, fjalët relacionale)
Java 8:	Predikacioni (brenda fjalisë, predikatet dhe argumentet, foljet, emrat, mbiemrat, rolet tematike, kufizimet gjatë selektimit)
Java 9:	Dekompozicioni I (qasja strukturaliste, aplikimi në rrafshin kuptimor)
Java 10:	Dekompozicioni II (tiparet semantike, formulat semantike, meta gjuha semantike e Wierbickas)
Java 11:	Kuptimi dhe krahasimi gjuhësor (problemet e përkthimit, relativizmi dhe univerzalizmi, fjalët e ngjyrave)
Java 12:	Kuptimi dhe kognicioni i (kategoritë dhe konceptet, teoria e prototipeve, renditja hierarkike e kategorive)

Java 13:	Kuptimi dhe Kognicioni II (vështirësitë e teorisë së prototipeve, semantika dhe teoria e prototipeve, dituria semantike)
Java 14:	Kuptimi i fjalisë dhe sematika formale I (skema e përgjithshme e semantikës kompozicionale, një fragment nga gjuha gjermane, modeli teorik i semantikës)
Java 15:	Kuptimi i fjalisë dhe semantika II ( botërat e mundshme, mundësitë dhe kufizimet e semantikës së botërave të mundshme, zhvillimi i semantikës së botërave të mundshme)

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat, nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.

## **Silabus i lëndës Autorë dhe modele (Antologji e veprave nëpër kohë)**

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
<b>Titulli i lëndës:</b>	Autorë dhe modele (Antologji e veprave nëpër kohë)
<b>Niveli:</b>	MA
<b>Statusi i lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti i V (semestri IX)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+0
<b>Kreditë ECTS:</b>	6 ECTS
<b>Koha / Vendi:</b>	Sipas orarit
<b>Mësimdhënësi:</b>	Prof. asoc. Dr. Albulena Blakaj- Gashi
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	Tel: 038222970/ <a href="mailto:albulena.blakaj@uni-pr.edu">albulena.blakaj@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Në lëndën <u>Autorë dhe modele (Antologji e veprave nëpër kohë)</u> do të bëhet një vështrim panoramik i letërsisë gjermane, duke u ndalur te autorë e vepra. Qëllimi i kursit është që studentët të familjarizohen me fenomenet që kanë sjellë ndryshimet më të mëdha brenda letërsisë gjermane. Pra, do të merren autorë e modele të cilët patën ndikim në letërsi, qoftë gjermane apo botërore duke filluar nga modeli gotik me Goethen, Bürgerin e Chamisson, te ai i poemës alegorike me Heinen, ai intelektualist me T. Mann, impresionist me Hessen, i poezisë moderne me Benn e Trakl, rivizitimit historik me Schlink e deri te modeli postmodern me Süskind. Lënda bazohet mbi një kriter kronologjik, por parimi i saj është antologjik (përzgjedhës).



**Qëllimet e lëndës:**

- t'i jap një pasqyrë panoramike të autorëve e veprave të rëndësishme të letërsisë gjermane,
- t'i ofrojë studentëve një pasqyrë të përgjithshme të modeleve në letërsi
- t'i familjarizojë studentët me fenomenet që kanë sjellë ndryshimet më të mëdha brenda letërsisë gjermane
- t'u ofrojë studentëve mundësi për të reflektuar për vepra letrare e qasje të cilat patën ndikim dhe shërbyen si modele në letërsi, qoftë gjermane a botërore

**Rezultatet e pritshme të nxënies:**

Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të:

- dijnë për autorë e vepra të rëndësishme të letërsisë gjermane
- jenë të familjarizuar me fenomenet që kanë sjellë ndryshimet më të mëdha brenda letërsisë gjermane
- dijnë dhe të kenë një pasqyrë të përgjithshme për modele të letërsisë
- të dijnë për ndikimin e autorëve dhe veprave dhe ndryshimet që sollën në letërsinë gjermane e botërore
- të kuptojnë përzgjedhjen e veprave sipas një kriteri kronologjik, por të bazuar në parim antologjik

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	10	1	10
Konsultime me mësimdhënësin	10min	15	2.5

Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	5	15	75
Përgatitja për provimin final	20	1	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Total</b>			<b>152:25= 6.08 6 ECTS</b>

<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Lënda përbëhet nga 2 orë ligjërata në javë, ku do të jepet baza teorike. Mirëpo, mësimi mbahet edhe në formë interaktive. Meqë vend do t'i jipet edhe prezantimeve të punimeve seminarike dhe diskutimeve për to, studentët janë të obliguar të marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë dhe të zhvillojnë diskutime me kolegët.
--------------------------------	--

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi përfundimtar 50%</li> <li>• Punimi seminarik 20%</li> <li>• Aktiviteti në klasë 30%</li> </ul>
------------------------------	---

<b>Literatura primare:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Benn, Gottfried: Sämtliche Gedichte, Gebundene Ausgabe , Klett-Cotta; Auflage: 8., Aufl.2014</li> <li>– Böll, Heinrich: Ansichten eines Clowns, Deutscher Taschenbuch Verlag; Auflage: 29 (1. Januar 1967)</li> <li>– Brecht, Bertold: Furcht und Elend des Dritten Reiches, Suhrkamp, Taschenbuch – 1970</li> <li>– Brecht: Mutter Courage und ihre Kinder: Eine Chronik aus dem Dreißigjährigen Krieg (edition suhrkamp) Taschenbuch –1964</li> <li>– Bürger, Gottfried August: Lenore, Nabu Press, 2010</li> <li>– Chamisso, Adelbert von: Peter Schlemihls wundersame Geschichte, (Suhrkamp Basis Bibliothek), 2003</li> <li>– Heine, Heinrich: Atta Troll, Reclam, Philipp, jun. GmbH, Verlag (1986)</li> <li>– Hesse, Hermann: Der Steppenwolf, Bibliothek Suhrkamp, 1970</li> <li>– J. V. Goethe: Faust: Der Tragödie erster und zweiter Teil. Urfaust,</li> </ul>
----------------------------	--

	<p>C.H. Beck, Auflage: 2, 2010</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Mann, Thomas: Der Tod in Venedig. Novelle. Fischer, 1992</li> <li>– Schlink, Bernhard: Der Vorleser, Diogenes, 1997</li> <li>– Süskind, Patrik: Das Parfum-Die Geschichte eines Mörders, Diogenes, 1994</li> <li>– Trakl, Georg: Das dichterische Werk, dtv, München 1972</li> <li>– Doerr, Kurwinkel (Hrsg): <i>Intertextualität, Intermedialität, Transmedialität</i>, Königshausen u. Neumann, 2014</li> </ul>
<b>Literatura shitesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Düsing, Edith/ Klein D, Hans (Hrsg): Geist und Literatur: Modelle in der Weltliteratur von Shakespeare bis Celan 2008</li> <li>– Nunning, Vera/ Nunning, Ansgar: Erzähltheorie transgenerisch, intermedial, interdisziplinär Taschenbuch – Oktober 2002 und:</li> <li>– Neue Ansätze in der Erzähltheorie Taschenbuch – Oktober 2002</li> <li>– Koschorke, Albrecht: Wahrheit und Erfindung: Grundzüge einer Allgemeinen Erzähltheorie Gebundene Ausgabe – 4. Oktober 2012</li> </ul>

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Njohja me lëndën
Java 2:	Autorët, modelet dhe fenomenet e ndryshimeve të mëdha
Java 3:	Modeli Sturm und Drang: aplikimi në dramë
Java 4:	Modeli Sturm und Drang: aplikimi në prozë e poezi
Java 5:	Modeli gotik (Chamisso, Goethe, Bürger)
Java 6:	Modeli gotik (Goethe: Faust)
Java 7:	Poema alegorike (Heine: Atta Troll)
Java 8:	Modeli intelektualist (Thomas Mann)
Java 9:	Modeli impresionist: (Hermann Hesse: Steppenwolf)
Java 10:	Drama epike (Bertold Brecht)
Java 11:	Proza e angazhuar (Heinrich Böll)
Java 12:	Modeli i poezisë moderne (G. Benn, G. Trakl)
Java 13:	Rivizitimi i historisë (Bernhard Schlink: Der Vorleser)
Java 14:	Modeli postmodern, romani mbi tehuajsimin (P. Süskind: Parfumi)

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.

## Silabus i lëndës *Metodologji e punës shkencore*

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Metodologji e punës shkencore
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti V, semestri IX
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Sadije Rexhepi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:sadije.rexhepi@uni-pr.edu">sadije.rexhepi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Në këtë lëndë studentët do të mësojnë dhe ushtrojnë të shkruarit e teksteve funksionale që iu nevojiten studentëve gjatë studimit, si punim shtëpie, seminare si dhe të punuarit e punimit final, pra punimit të masterit.</p> <p>Këtu do të mësohet për metodat e punimeve shkencore, për metodat e grumbullimit të materialit hulumtues, përpunimin e materialit të hulumtuar, hartimin e fusnotave, të civateve sipas normës ndërkombëtare, hartimin e përmbajtjes, bibliografisë, regjistrin të emrave dhe të shprehjeve etj., të cilat do t'i shërbenin studentit për hartimin e punimeve me shkrim gjatë studimeve si dhe në fund për hartimin e punimit të masterit dhe prezantimin e tij.</p> <p>Me rëndësi këtu është të mësohen hapat e hulumtimit dhe mënyra e analizës praktike e korpusit për të nxjerrë rezultate të mira të hulumtimit për një temë të caktuar. Këtu studentët duhet të ambientohen me vlerësimin kritik të raporteve të publikuara të hulumtimeve kuantitative dhe kualitative në fushën tonë.</p>

Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimet e kësaj lënde janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të njoftohen studentët me mënyrat e përpilimit të një ekspozije (projekt-propozimi),</li> <li>- të njoftohen studentët me fazat e hulumtimit,</li> <li>- të njoftohen me mënyrat e hulumtimit të literaturës,</li> <li>- të informohen studentët me teknikat e nevojshme për hartimin e një punimi shkencor,</li> <li>- të njoftohen studentët me metodologjinë hulumtuese empirike, kuantitative dhe kualitative,</li> <li>- të njoftohen studentët me metodologjinë kontrastive dhe krahasimtare,</li> <li>- të njoftohen studentët me prezantimin e një punimi shkencor.</li> </ul>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të dinë të përpilojnë ekspozitë,</li> <li>- të njohin metodat hulumtuese të aplikueshme në fushën e tyre të studimit,</li> <li>- të vlerësojnë në mënyrë kritike raportet e publikuara në fushën e tyre të studimit,</li> <li>- të planifikojnë hulumtimin e tyre,</li> <li>- të aplikojnë metodologjinë hulumtuese kuantitative dhe kualitative në hulumtimin e tyre,</li> <li>- të aplikojnë metodologjinë hulumtuese kontrastive dhe krahasimtare në hulumtimin e tyre,</li> <li>- të prezantojnë hulumtimin e tyre.</li> </ul>

<b>Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)</b>			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.30
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	10	6	60
Detyrë shtëpie	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15

Përgatitja për provimin final	10	2	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	45 min	2	1.5
<b>Total</b>			<b>146.1 orë (146.1:25 = 5.84) 6 ECTS</b>

<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike, konsultimeve dhe ushtrimeve që realizohen me punë në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi. Po ashtu punohen edhe projekte, seminar, të cilat referohen dhe rreth të cilave diskutohet në orë.
--------------------------------	--

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit dhe detyrat individuale të kryera në shtëpi 10% Ekspozé 20% Punimi i seminarit 50% Prezantimi në klasë 20%
------------------------------	---

<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Duden. 2012. <i>Wie schreibt man wissenschaftliche Arbeiten?</i> Mannheim.</li> <li>2. Eco, Umberto. 2007. <i>Wie man eine wissenschaftliche Abschlussarbeit schreibt.</i> Heidelberg.</li> <li>3. Gruber / Huemer / Rheindorf. 2009. <i>Wissenschaftliches Schreiben. Ein Praxisbuch für Studierende.</i> Weimar.</li> <li>4. Kornmeier, Martin. 2008. <i>Wissenschaftlich Schreiben leicht gemacht - für Bachelor, Master und Dissertation,</i> Bern.</li> <li>5. Grätz, Frank. 2006. Duden. <i>Wie verfasst man wissenschaftliche Arbeiten?: Ein Leitfaden für das Studium und die Promotion.</i> Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich.</li> <li>6. Balzert/Schröder/ Schäfer. 2012. <i>Wissenschaftliches Arbeiten,</i> Wilhelm Büchner Hochschule, Darmstadt.</li> <li>7. Rothstein, Björn. 2011. <i>Wissenschaftliches Arbeiten für Linguisten,</i> Narr Verlag, Tübingen.</li> <li>8. Esselborn- Krumbiegel, Helga. 2010. <i>Richtig wissenschaftlich schreiben. Wissenschaftssprache in Regeln und Übungen,</i> UTB, Stuttgart.</li> <li>9. Bünning, Karl-Dieter; Bitterlich, Axel; Postpiech, Ulrike. 2000. <i>Schreiben im Studium mit Erfolg,</i> Ein Leitfaden, Berlin.</li> </ol> <p>Esselborn- Krumbiegel, Helga. 2010. <i>Richtig wissenschaftlich schreiben. Wissenschaftssprache in Regeln und Übungen,</i> UTB, Stuttgart.</p>
----------------------------	--

Literatura shitesë:	<p>10. Karmasin, Mathias, Ribing, Rainer: <i>Die Gestaltung wissenschaftlicher Arbeiten: Ein Leitfadens für Seminararbeiten</i>, Stuttgart, 2010.</p> <p>11. Trapp, Sebastian. (2007) <i>Wie man tatsächlich eine wissenschaftliche Arbeit schreibt: Daten, Schreibtechnik, Zeitplanung, Veröffentlichung - in der realen Welt</i>.</p> <p>12. Pospiech, Ulrike. (2005) <i>Duden Ratgeber - Wie schreibt man wissenschaftliche Arbeiten? Alles Wichtige von der Planung bis zum fertigen Text</i>. Mannheim.</p>
---------------------	--

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Njoftimi me lëndën, me planin e lëndës
Java 2:	Procesi i të shkruarit – parashkrimi dhe planifikimi
Java 3:	Etapat e hulumtimit për një punim shkencor
Java 4:	Procesi i të shkruarit-shkrimi dhe redaktimi i projekt-ideve
Java 5:	Të shkruarit një exposéje
Java 6:	Metodologjia hulumtuese kuantitative dhe kualitative
Java 7:	Metodologjia kontrastive dhe krahasimtare
Java 8:	Gjuha dhe stili i punimit shkencor
Java 9:	Argumentimi; Rrjedha kronologjike dhe logjike, rrjedha e shkakut dhe e pasojës si dhe e krahasimit dhe kontrastimit
Java 10:	Standardet e tekstualitetit
Java 11:	Analiza praktike e korpusit
Java 12:	Citimet, dokumentimi i burimeve
Java 13:	Redaktimi
Java 14:	Prezantimi i punimeve seminarike
Java 15:	Prezantimi i punimeve seminarike

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes



Studentët marrin pjesë aktive në ligjëratë, për t'i thelluar njohuritë nga kjo fushë. Ata e zhvillojnë vetën me aktivitete jashtë mësimore, si: konferenca, biblioteka, detyra dhe seminare. Aktivitete mësimore dhe jashtë mësimore u kontribuojnë në formimin më të mirë të tyre, në këtë fushë.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën në heshtje për të marrë shënime; aktivitete të tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimt. Nga të gjithë pritet të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve gjatë diskutimeve, dhe nuk bën të përdorët gjuhë e pahijshme.

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit.

## LËNDËT MËSIMORE – ME ZGJEDHJE

### Silabus i lëndës Gramatikalizimi

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Gramatikalizimi
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	me zgjedhje
Viti i studimeve:	viti i V-të, semestri i 9-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. dr. Teuta Abrashi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:teuta.abrashi@uni-pr.edu">teuta.abrashi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Në këtë lëndë trajtohen aspektet fonologjike, morfosintaksore dhe semantike të fenomeneve të gramatikalizimit duke u bazuar në disa shembuj (p.sh. zhvillimi i nyjes, i foljeve ndihmëse dhe modale, i sistemit të negacionit dhe të lidhëzave). Termi „Gramatikalizim“ përshkruan procesin diakronik të transformimit të njësive leksikore dhe sintagmave në pjesë të gramatikës së një sistemi gjuhësor. Një shembull i zhvillimeve të tilla është e kryera perifrastike e gjermanishtes që formohet me foljen ndihmëse <i>haben</i> (kam) dhe pjesoren. Folja ndihmëse <i>haben</i> është gramatikalizuar nga folja e plotë <i>kam</i> „posedoj“.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"><li>- përvetësimi i koncepteve themelore të gramatikalizimit</li><li>- që studentët t'i kuptojnë proceset e gramatikalizimit në gjuhën gjermane</li><li>- sqarimi i zhvillimeve fonologjike, morfosintaksore dhe semantike që vijnë si rezultat i procesit të gramatikalizimit në</li></ul>

	gjuhën gjermane
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:
	– t'i dallojë konceptet teorike nga fusha e gramatikalizimit
	– t'i sqarojë proceset e gramatikalizimit në gjuhën gjermane
	– t'i kuptojë zhvillimet fonologjike, morfosintaksore dhe semantike që vijnë si rezultat i procesit të gramatikalizimit në gjuhën gjermane

#### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	3,45
Testi, punimi i seminarit	1	2	2
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	30	30
Përgatitja për provimin final	4	7	28
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Total</b>			<b>105,95:25=4.23 4 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike. Studentët obligohen ta përgatisin dhe ta prezantojnë një seminar me shkrim nga kjo lëndë.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punimi seminarik 30%</li> <li>• Pjesëmarrja aktive 10%</li> <li>• Provimi final 60%</li> </ul> <b>Provimi:</b> Provim përmblendhës në afatin e provimeve. Provimi është vetëm

	me shkrim.
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. T. Stolz (2008) Grammatikalisierung und grammatische Kategorien. Bochum</li> <li>2. R. Szczepaniak (2009) Grammatikalisierung im Deutschen: Eine Einführung. Tübingen.</li> <li>3. T. Leuschner &amp; T. Mortelmans &amp; S. De Groot (Hg.) (2005) Grammatikalisierung im Deutschen. Berlin.</li> </ol>
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Levin-Steinmann (2010) Studien zur Grammatikalisierung. Hamburg.</li> <li>2. G. Diewald (1997) Grammatikalisierung: eine Einführung in Sein und Werden grammatischer Formen. Tübingen.</li> <li>3. E. C. Traugott &amp; B. Heine (Hg.) (1991) Approaches to Grammaticalization. 2 Bde. Amsterdam</li> </ol>

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje -qëllimi i lëndës ç'është gramatikalizimi? elementet leksiokore dhe gramatikore
Java 2:	Parametrat e gramatikalizimit atenuacioni (dobësimi) fonologjike
Java 3:	Ndryshimi semantikë: atenuacioni semantik, pasurimi pragmatik, rianalizimi
Java 4:	Faktoret kognitive: metafora dhe metonimia, subjektivizimi
Java 5:	Kontekste dhe konstrukcione
Java 6:	Gramatikalizimi në fushën verbale zhvillimi i perfektit, formimi i pësorës, ndryshimet në sistemin e aspektit
Java 7:	Gramatikalizimi në fushën nominale Formimi i sistemit të nyjave, shquarsia pragmatike dhe semantike
Java 8:	Struktura informatike dhe pozicioni i fjalës Fleksioni mbiemrore, faktoret aspektuale, ndryshimet në sistemin nominal
Java 9:	Zhvillimi i peremrit posesivë, rianalizimi i gjenitivit prenominal
Java 10:	Gramatikalizimi i nyjes së shquar nga peremrit demonstrativ
Java 11:	Nyja e pashquar ein dhe sum
Java 12:	Gramatikalizimi tek mbiemrave, ndryshimi

Java 13:	Gramatikalizimi tek ndajfolje
Java 14:	Gramatikalizimi dhe ndryshimi në Sprachwandeltheorie
Java 15:	Fiksimi i radhës së fjalëve në fjali dhe zhvillimi i shënuesve të diskursit

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjërata, nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.

## Silabus i lëndës Gramatika funksionale dhe struktura informative

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Gramatika funksionale dhe struktura informative
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	viti i V-të, semestri i 9-të
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. dr. Teuta Abrashi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:teuta.abrashi@uni-pr.edu">teuta.abrashi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Secila gjuhë ka një renditje të caktuar të gjymtyrëve gramatikore, madje disa prej tyre si gjermanishtja dhe gjuha shqipe kanë më shumë se një mundësi apo opsion. Arsyeja e një dallimi të këtillë ndërmjet gjuhëve është se ato bëjnë kodifikime të ndryshme funksionale të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në strukturën informative të fjalisë. Kjo lëndë ka për qëllim për të njoftuar studentët me parimet dhe mjetet themelore të gramatikës funksionale dhe strukturën informative të fjalisë, nëpërmjet të cilave do të shpjegohet jo vetëm një renditje specifike e gjymtyrëve por gjithashtu do të mësohet se kur është e nevojshme të përdoret një renditje e caktuar në momentin e dhënë.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i njoftojë studentët me parimet dhe mjetet themelore të gramatikës funksionale dhe strukturën informative të fjalisë</li> <li>- t'i vetëdijësojë studentët me konceptin dhe problematikën e renditjes së caktuar të gjymtyrëve gramatikore (kodifikimi të ndryshme funksionale)</li> <li>- t'ua mundësojë të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për gramatikën funksionale</li> </ul>

	dhe struktura informative e gjuhës gjermane
--	---

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:
	- t'i identifikojë dhe t'i shpjegojë nocionet dhe termat që kanë të bëjnë me gramatikën funksionale dhe struktura informative
	- t'i shpjegojë dhe t'i ilustrojë kodifikime të ndryshme funksionale dhe të përpiqet t'i zbatojë në shembuj konkretë nga gjuha gjermane
	- t'i ilustrojë konkretisht renditje specifike e gjymtyrëve

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2,30
Testi, punimi i seminarit	1	2	2
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	4	7	28
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Total</b>			<b>104,8:25=4.19 4 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike, përgatitjes dhe prezantimit të punimeve seminarike dhe detyrave të vazhdueshme në shtëpi.
-------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punimi seminarik 30%</li> <li>• Pjesëmarrja 10%</li> <li>• Provimi 60%</li> </ul> <p><b>Provimi:</b> Kusht për provim është punimi seminarik. Provim përmbledhës në afatin e provimeve. Provimi është vetëm me shkrim.</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Smirnova, Elena/ Mortelmans, Tanja (2010): Funktionale Grammatik – Konzepte und Theorien, Berlin/New York: de Gruyter</li> <li>2. Musan, Renate (2010): Informationsstruktur. Universitätsverlag Winter, Heidelberg</li> <li>3. Hoffmann, Ludger (2012): Deutsche Grammatik. Grundlagen für Lehrer-ausbildung, Schule, Deutsch als Zweit-sprache und Deutsch als Fremdsprache. Berlin: Erich Schmidt</li> <li>4. Jungen, Oliver/ Lohnstein, Horst (2006): Einführung in die Grammatiktheorie. München: Wilhelm Fink Verlag</li> <li>5. Hoffmann, Ludger (Hrsg.) (2003): Funktionale Syntax. Berlin/New York: de Gruyter</li> </ol>
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zifonun, Gisela et. al (1997): Grammatik der deutschen Sprache: 3 Bde. (Supplementa Nietzscheana), Berlin/New York: de Gruyter</li> <li>2. Busch,A./Stenschke,O.(2007): Germanistische Linguistik, Tübingen: Narr Franke (S.75-114)</li> <li>3. Meibauer, J. (et.al) (2002): Einführung in die germanistische Linguistik, Stuttgart: Metzler (S.15-67)</li> </ol>

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Qëllimi i lëndës, hyrje (Çështje gjuha, gjuha si organ, gjuha si vegël, gjuha si veprim, gjuha si system)
Java 2:	Çështje të përgjithshme të gramatikës funksionale (fjalë dhe thënia, gjymtyrët e fjalisë, kuptimi gramatikor, semantikë dhe pragmatikë i fjalisë)
Java 3:	Subjekti e predikati
Java 4:	Struktura informative e fjalisë (tema rhema, informata e njohua dhe e re dhe dimensionet e tjera të fjalisë)
Java 5:	Realizimi i strukturës informative (mjetet prozodike, sintaksore, leksikore)
Java 6:	Aktet e të folurit (ilokucionit, modaliteti)
Java 7:	Ndërtimi i gramatikës funksionale I (struktura, sistemi)
Java 8:	Ndërtimi i gramatikës funksionale II (stratifikacioni, metafunkcionet)



Java 9:	Analiza e fjalisë I (fjalja si përfaqësim)
Java 10:	Analiza e fjalisë II (fjalja si porosi)
Java 11:	Analiza e fjalisë III (fjalja si interaksion)
Java 12:	Dimensioni i fokusit dhe sfondi
Java 13:	Struktura informative komplekse: topikat kontrastive
Java 14:	Faktoret për pozitën e fjalës në fjali (dimensionët informative- strukturale)
Java 15:	Teksti, quaestio dhe struktura informative

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjërata, nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.

## Silabus i lëndës Semiotikë

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Semiotikë
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	Viti i V-të   Semestri i 9-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Blertë Ismajli
Të dhënat kontaktuese:	eMail: blerte.ismajli@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Qëllimi i lëndës është që të jepet baza e semiotikës. Lënda synon t'i mësojë studentët që t'i identifikojnë, kuptojnë dhe shfrytëzojnë konceptet bazë të semiotikës, të japë informacion për strukturat metalinguistike, mënyrën si pasqyrohet njohuria për botën. Në kuadër të kursit studentët do të marrin informacione të përgjithshme mbi shenjat, konceptet e autorëve të ndryshëm për shenjën (de Saussure, Peirce etj.).
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i njoftojë studentët me konceptet themelore të semiotikës</li> <li>- t'i sqarojë konceptet e ndryshme për shenjën</li> <li>- njoftojë studentët me funksionet e shenjës gjuhësore</li> </ul>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– t'i sqarojë konceptet themelore të semiotikës</li> <li>– të identifikojë strukturat që janë aktive në gjuhë</li> </ul>

	– të përdorë terminologjinë specifike për fushën
	- t'i shfrytëzojë teorinë dhe metodat e fushës

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike	1	15	15
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	6	3
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	1	15	15
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			3
Përgatitja për provimin final	10	2	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.			
<b>Total</b>			<b>97,5:25=3.9 4 ECTS</b>

<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike. Studentët obligohen ta përgatisin dhe ta prezantojnë një seminar me shkrim nga kjo lëndë.
--------------------------------	---

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punimi seminarik 30%</li> <li>• Pjesëmarrja aktive 10%</li> <li>• Provimi final 60%</li> </ul>
------------------------------	---

<b>Literatura primare:</b>	1. Volli, Udo (2002). Semiotik. Eine Einführung in ihre Grundbegriffe, utb, Stuttgart 2. Eco, Umberto (1994). Einführung in die Semiotik. Autorisierte dt. Ausgabe. 8., unveränd. Auflage von Jürgen Trabant. München
----------------------------	--

	<p>3. Chandler, Daniel (2002). Semiotics – the basics, Second Edition, Routledge, London and New York.</p> <p>4. Copley, Paul and Jansz, Rita (1997). Introducing Semiotics, Totem Books USA and Icon Books UK, This edition published by Icon Books UK.</p>
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Barthes, Roland (1991). Aventura semiologjike, Prishtinë.</li> <li>2. Brown, Martin and Ringham, Felizitas (2000). Dictionary of Semiotics, Casell, London and New York.</li> <li>3. Danesi, Marcel (2004). Messages, Signs and Meanings, A Textbook in Semiotics and Communications, 3rd edition, Canadian Scholar's Press Inc, Toronto.</li> <li>4. De Saussure, Ferdinand, Kurs i gjuhësisë së përgjithshme, botimi i dytë i rishikuar, Dituria, Tiranë 2002</li> <li>5. Eco, Umberto, Struktura e papranishme, Dukagjini, Pejë.</li> </ol>

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje në konceptet themelore dhe materialet që do të ligjërohen; Ç'është semiotika?
Java 2:	Komunikimi: Faktorët dhe funksioni i komunikimit; modelet e komunikimit.
Java 3:	Shenja (Strukturalizmi): Koncepti i shenjës; shenjuesi-i shenjuari; arbitrariteti; konotacioni; invariantet dhe variantet; gjuha dhe jogjuha; modeli organon i gjuhës; natyra shenjuese e gjuhës; origo dhe markimi i saj (Strukturalizmi funksional)
Java 4:	Strukturat: Aksi sintagmatik dhe ai paradigmatic; shprehja dhe përmbajtja; njësitë minimale dhe tiparet distinktive; semantika; kuadrati semiotik; teksti dhe diskursi; topika, izotopia
Java 5:	Interpretimi: Strategjitë e diskursit; interpretimi dhe përdorimi i teksteve
Java 6:	Akti i te shprehurit: Subjektiviteti; indiciet gjuhësore të shprehjes
Java 7:	Metafora: Konceptet për metaforën; metonimia dhe ironia; metafora dhe kultura
Java 8:	Përtej kufijve të tekstit: Hapësira; vizualja; objektet; komunikimi joverbal; proceset e përkthimit; tekstet dhe hipertekstet; interneti
Java 9:	Narracioni: Nivelet e narracionit; fokalizuesi dhe narratori; fabula; botët e mundshme; niveli i veprimeve; aktantët; modalitetet
Java 10:	Pragmatika: Fushat e komunikimit; aktet e të folurit; dialogu dhe interaksioni; përfundimet dhe implikaturat; maksimat e konverzacionit; rregullat e politesës; retorika klasike

Java 11:	Jeta shoqërore e tekstit: Kulturat; semiosfera; informata nga perspektiva semiotike; reklama; politika; televizioni
Java 12:	Fushat e zbatimit: Letërsia; teatri; filmi; filmi i ilutstruar; muzika
Java 13:	Post-strukturalizmi dhe studimet kulturore (Cultural Studies), “Gender”
Java 14:	Intertekstualiteti
Java 15:	Përmbledhje e lëndës dhe përgatitja për provimin final.

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t’i vijojnë ligjëratat, nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.

## Silabus i lëndës *Autor i zgjedhur 1*

Informatat themelore për lëndën	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
<b>Titulli i lëndës:</b>	Autor i zgjedhur 1
<b>Niveli:</b>	MA
<b>Statusi i lëndës:</b>	Zgjedhore
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti i V (semestri IX)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+0
<b>Kreditë ECTS:</b>	4 ECTS
<b>Koha / Vendi:</b>	Sipas orarit
<b>Mësimdhënësi:</b>	Prof. asoc. Dr. Albulena Blakaj- Gashi
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	Tel: 038222970/ albulena.blakaj@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Lënda zgjedhore " <i>Autor i zgjedhur</i> " jep mundësinë e fokusimit te një autor i rëndësishëm gjerman, apo gjermanishtfolës. Marrja intensive me një autor të veçantë brenda një semestri bën të mundshëm casjen më të afërt karshi autorit të zgjedhur dhe trajtimin e veprës së plotë të tij, ose së paku pjesës më të madhe e saj. Do të merremi me autorë të cilët, jo vetëm se janë emër edhe në mesin e autorëve më të mëdhenj botëror, por edhe vepra e të cilëve ishte me ndikim në zhvillimin e letërsisë botërore. Në fokus do të jenë shkrimtarët e mëdhenj të shekujve 18, 19 apo të fillimit të shekullit 20. Letërsia gjermane ka një numër të madh shkrimtarësh të cilët janë fitues të çmimit Nobel për letërsi e pjesë e këtij kursi do të jetë edhe ndonjëri prej tyre.

## Qëllime e lëndës:

- Kjo lëndë ka për qëllim fokusimin te një autor i rëndësishëm gjerman, apo gjermanishtfolës vepra letrare e të cilit është shembull dhe ka pasur e ka ndikim në zhvillimet letrare e kulturore;
- Qasjen më të afërt karshi autorit të zgjedhur, që bën të mundur trajtimin e veprës së plotë të tij;
- Njohjen e studentëve me rëndësinë e autorit dhe veprës së tij në letërsinë gjermane e botërore, përfshi edhe ndikimin e tyre në zhvillimet letrare;
- T'i ndihmojë studentët të krijojnë mendim të pavarur për zhvillimet letrare brenda epokës letrare në të cilën shtrihet veprimtaria e autorit, për veprën letrare, etj, dhe ta shpreh atë e të debatojë me kolegët.

**Rezultatet e pritshme të nxënies:**

- Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të:
- njoh në detaje ndonjërin nga autorët kryesorë të letërsisë gjermane të cilët zënë vend të rëndësishëm në letërsinë botërore;
  - të ketë njohuri për veprën complete të autorit të zgjedhur,
  - dijë për rëndësinë e veprës së autorit në letërsinë gjermane e botërore
  - jetë në gjendje të shkruaj një seminar të detajuar për ndonjë nga veprat e autorit të zgjedhur
  - zhvillojë aftësinë e krijimit të mendimit të pavarur rreth një vepre letrare dhe të zhvillojë debat me kolegët e tij rreth një teme nga letërsia
  - të jetë në gjendje ta shprehë qartë mendimin e krijuar për një temë a vepër të caktuar;

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	10	2	20
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	3.75
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30



Përgatitja për provimin final	10	1	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Total</b>			108.25:25= 4.33 4 ECTS

<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Lënda përbëhet nga 2 orë ligjërata në javë, ku do të jepet baza teorike. Mirëpo, mësimi mbahet edhe në formë interaktive dhe orët do të koncentrohen edhe në prezantimet e diskutimet e studentëve të cilët do të punojnë edhe nga një seminar për njërën nga veprat e autorit të zgjedhur. Temë kjo, të cilën e zgjedhin vet nga lista e dhënë. Gjatë orëve prezantohen edhe punimet e bëra dhe për to diskutohet në klasë. Diskutimi përfshin periudhat letrare të cilës i takojnë veprat, biografinë e autorit, krijimtarinë dhe vendin e tij në letërsinë gjermane e botërore.
--------------------------------	--

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi përfundimtar 40%</li> <li>• Punimi seminarik 40%</li> <li>• Aktiviteti në klasë 20%</li> </ul>
------------------------------	---

<b>Literatura primare:</b>	Do të caktohet pas caktimit të autorit që do të trajtohet. Poashtu edhe plani i detajizuar.
----------------------------	---

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.

## Silabus i lëndës *Letërsia bashkëkohore gjermane*

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	<i>Letërsia bashkëkohore gjermane</i>
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Zgj.
Viti i studimeve:	viti i V-të, semestri i 9-të
Numri i orëve në javë:	2
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.asoc.dr. Naser Mrasori
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:Naser.Mrasori@uni-pr.edu">Naser.Mrasori@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda "Letërsia bashkëkohore gjermane" ka për qëllim t'i njoh studentët me proceset, rrymat, drejtimet dhe epokat e zhvillimit të letërsisë gjermane, duke filluar me letërsinë pas vitit 1945, e duke vazhduar deri në ditët e sotme. Pas bashkimit të dy Gjermanive, të cilat deri atëherë kishin krijuar letërsitë e veta veç e veç, letërsi këto të cilat kishin ndërtuar koncepte të ndryshme krijuese. Këto letërsi të ndryshme ishin zhvilluar me një pluralizëm stileshe dhe formash thuajse krejtësisht të ndryshme letrare.</p> <p>Në këtë kurs trajtohen autorët kryesorë të fundshekullit 20 dhe fillimit të shek. 21, sidomos veprat më të rëndësishme dhe njëkohësisht më të njohura e me më ndikim në letërsinë gjermane dhe botërore. Veprat e kësaj periudhe janë shumë, ku bëjnë pjesë edhe veprat e autorëve fitues të Çmimit Nobel për Letërsi.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i kësaj lënde është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihen studentët me karakteristikat dhe konceptet themelore të letërsisë bashkëkohore gjermane.</li> <li>- të njihen studentët me rrjedhën dhe me ngjarjet më të rëndësishme të kësaj periudhe.</li> <li>- të njihen me temat, gjinitë dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe.</li> <li>- të njihen me rolin dhe karakteristikat e veprave më të shquara të kësaj periudhe.</li> <li>- të njihen me krijimtarinë letrare pas bashkimit të dy gjermanive.</li> </ul>

Rezultatet e pritshme të nxënies:

- Pas përfundimit të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje:
- Lënda “Letërsi bashkëkohore” ka për qëllim, që studentët të njihen, me:
- me karakteristikat dhe konceptet themelore të letërsisë bashkëkohore gjermane.
  - me rrjedhën dhe me ngjarjet me të rëndësishme të kësaj periudhe.
  - me temat, gjinitë dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe.
  - me rolin dhe karakteristikat e veprave më të shquara të kësaj periudhe.
  - me krijimtarinë letrare pas bashkimit të dy gjermanive.
  - me krijimtarinë e fundshekullit XX.

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Konsultimet	10 min	15	2.5
Kollokviume / Seminare	5	2	10
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak(bibliotekë, shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare	6	2	12
Koha e kaluar në vlerësim (test, provim)	1	1	1
Projekte, prezantime	30	1	0.5
<b>Total</b>			<b>93.5</b> <b>93.5:25 =</b> <b>3.74</b> <b>4 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:

Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me shpjegime përkatëse për rrjedhën historike dhe letrare të letërsisë pas vitit 1945 deri më sot. Gjatë shpjegimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Diskutohen shembuj nga krijimtaria e autorëve me në zë të kësaj periudhe, për gjinitë e ndryshme letrare si dhe komentohen ngjarjet kryesore të periudhës bashkëkohore. Në fillim do të jepen informacione të përgjithshme për vitet e para të pasluftës e më pas duke vazhduar në mënyrë kronologjike rrjedhën e krijimtarisë letrare. Fokusi kryesor do të jenë temat dhe autorë nga

	letërsia bashkëkohore gjermane. Gjatë realizimit të këtij kursi, shfrytëzohet literaturë e pasur burimore dhe zbatohen metoda interaktive.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi është paraparë të bëhet mbështetur në statutin e Universitetit të Prishtinës ( provimi me shkrim dhe me gojë), dhe duke pasur parasysh edhe punën dhe angazhimin e studentëve gjatë vitit akademik si psh. Pjesëmsrria, anazhimi, punimet seminarike, testet, referimet, diskutimet etj.
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Barner,Wilfried: Geschichte der deutschen Literatur von 1945 bis zur Gegenärt.Verlag C.H.Beck Muenchen 1994. ISBN3 406 38660 1</li> <li>2. Heinz Forster &amp; Paul Rieger: Deutsche Literaturgeschichte. Band 11 &amp; 12.dtv Muenchen 2002. ISBN 3-423-03351-7 / 3-423-03352-5</li> <li>3. Joachim Bark,Dietrich Steinbach, Hildegard Wittenberg Hrsg: Epochen der deutschen Literatur (Gesamtasugabe) Klett,Stuttgart 1989. ISBN 3-12-347490-9</li> <li>4. Joachim Bark,Dietrich Steinbach, Hildegard Wittenberg Hrsg .Geschichte der deutschen Literatur von 1945 bis zur Gegenwart.Klett, Stuttgart . ISBN 3-12-347470-4</li> <li>5. Gerald reiner, Norbert Kern, Eva Rainer: Geschichte der deutschsprachigen Literatur. Veritas Verlag Linz. 4 Auflage 2004.</li> </ol>
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. H. Brackert, J. Stueckrath:Literaturwissenschaft - Ein Grundkurs /rororo.2001 Hamburg. ISBN 3 499 55523 9</li> <li>2. Winfried Freund: Deutsche Literatur. Dumont,2002 Köln. ISBN 3-7701-4747-2</li> </ol>

### Hartimi i planit mësimor

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<b>Java e parë:</b>	Letërsia gjermane e pasluftës (Letërsia pas 1945) Grupi 47 dhe Ora Zero (Stunde Null)
<b>Java e dytë:</b>	Ndarja e gjermanisë Letërsia në DDR & BRD
<b>Java e tretë:</b>	Letërsia e viteve 50, 60
<b>Java e katërt:</b>	Kontributi dhe kthimi i autorëve gjerman nga ekzili dhe ndikimi i letërsive të huaja në gjermaninë e pasluftës

<b>Java e pestë:</b>	Fillimi i letërsisë bashkëkohore gjermane
<b>Java e gjashtë:</b>	Letërsia bashkëkohore në Austri dhe Zvicër
<b>Java e shtatë:</b>	Letërsia e viteve 70, 80 ( Feminizmi dhe kthimi i mitit në letërsi)
<b>Java e tetë:</b>	Postmodernizmi
<b>Java e nëntë:</b>	Letërsia e viteve të 90 ( Ribashkimi i dy gjermanive dhe dy letërsive)
<b>Java e dhjetë:</b>	Autorët kryesorë të viteve të 90, krijimtaria e tyre, gjinitë letrare. Temat dhe diskutimet letrare (për lindjen dhe perëndimin “ West – Ost”)
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Veprat kryesore të letërsisë bashkëkohore gjermane
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Lirika
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Epika
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Drama
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Karakteristikat kryesore të gjinive letrare në letërsinë bashkëkohore gjermane.

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Gjatë këtij kursi studentët thellojnë dijet në këtë fushë duke qenë aktiv në pjesëmarrje, të angazhuar gjatë ligjëratave dhe në punët seminarike. Vijueshmëria e rregullt u ndihmon që ata të kenë më shumë të dhëna në përkufizimet e kësaj fushe, temat dhe motivet e letërsisë bashkëkohore, ndikimet, studentët do të njihen edhe me proceset dhe epokat e zhvillimit të letërsisë gjermane, duke filluar me letërsinë pas vitit 1945, e duke vazhduar deri në ditët e sotme. Prandaj ata duhet të vijnë me kohë dhe të motivuar dhe të përgatitur në auditor, mosardhja e rregullt dhe me kohë, sjell ndërprerjen e mësimnxënies dhe i shkakton ndërprerje të marrjes së informacioneve të duhura për pergaditjen e lëndës.

## Silabus i lëndës *Didaktika e letërsisë*

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë: Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë gjermane
Titulli i lëndës:	Didaktikë e letërsisë
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	Viti V, semestri IX
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. phil. Naim Kryeziu
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:naim.kryeziu@uni-pr.edu">naim.kryeziu@uni-pr.edu</a> naimkryeziu@bluewin.ch
Përshkrimi i lëndës:	Synimi i “Didaktikës së letërsisë” është t’i njohë studentët me konceptet, me format dhe me metodat më të reja për studimin e mësimdhënies së kësaj lënde. Kërkesa parësore e lëndës në fjalë është që, gjatë këtij kursi, studentët të mësojnë e të përgatiten për të dhënë lëndën e letërsisë. Ky kurs u jep mundësi studentëve të njihen me përvojën e metodave didaktike që përqendrohen sidomos në teorinë dhe në praktikën e didaktikës së letërsisë. Studentët në këtë kurs fitojnë aftësi të reja metodiko-didaktike që janë të rëndësishme për perspektivën e tyre në mësimdhënie. Ata do të kenë mundësi t’i zbatojnë në praktikë njohuritë teorike të fituara në leksionet e kursit të kësaj lënde.
Qëllimet e lëndës:	Lënda “Didaktika e letërsisë” synon që studenti: <ul style="list-style-type: none"><li>• të njihet me konceptet dhe me metodologjitë kryesore për lëndën e didaktikës së letërsisë.</li><li>• të zotërojë mënyrat më të rëndësishme për formimin e tij,</li><li>• të fitojë aftësi dhe mjeshtëri për organizimin e procesit mësimor,</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>të zotërojë njohuritë bashkëkohore në fushën e mësimdhënies, të njohë teknikat e komunikimit dhe interpretimit në raportin mësimdhënës-student.</li> </ul>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studenti duhet të ketë njohuri të mjaftueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>për konceptet dhe për metodat në lëndën e didaktikës së letërsisë,</li> <li>për organizimin e mësimit,</li> <li>për aftësitë në të dëgjuar, në të shkruar dhe në të folur,</li> <li>për lëndën e didaktikës së letërsisë gjermane,</li> <li>për mjeshtërinë e zbatimit të metodave të mësimdhënies në lëndën e letërsisë, si dhe</li> <li>për interpretim e për komunikim.</li> </ul>

#### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.50
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	45 min.	15	2.25
Përgatitje për biseda ndërvepruese në lidhje me leksionet e zhvilluara	15 min.	15	3.75
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	15	30
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin përfundimtar	5	1	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi përfundimtar)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1

Total		110:25=4.42 4 ETCS
Format e mësimdhënies dhe të mësimnxënies:	Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me shpjegime përkatëse. Gjatë shpjegimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Në fillim të ligjërates zhvillohet gjithmonë debat për leksionin e mëparshëm. Në fund të ligjërates bëhet një përsëritje e përbashkët e leksionit pasues.	
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Testi i parë 15 %</li> <li>• Testi i dytë 15 %</li> <li>• Pjesëmarrja aktive në ligjërata 15%</li> <li>• Vijimi i rregullt në mësim 5 %</li> <li>• Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) 50%</li> </ul>	
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Literaturdidaktik, Prof. Dr. Mathias Kepser, Erich Schmidt Verlag GmbH, 2009</li> <li>2. Einführung in die Literaturdidaktik, Verlag: Metzler, 2009, ISBN-13:978347613176</li> <li>3. Grundsätze der Literaturdidaktik, Klaus Godal / Hermann Karte (Hgg.) ISBN-13:978342330987</li> </ol>	
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Deutschdidaktik, Christiane Hochstadt, Andreas Krafft, Rolph Olsen, Verlag Utb, Francke, ISBN-13:973825240233</li> </ol>	

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Didaktika si shkencë
Java 2:	Didaktika e letërsisë
Java 3:	Teoria dhe praktika e didaktikës së letërsisë
Java 4:	Fushat e studimit të didaktikës së letërsisë
Java 5:	Metodat teoriko-didaktike të letërsisë
Java 6:	Bazat metodologjike të të mësuarit
Java 7:	Format kryesore të didaktikës të organizimit të procesit mësimor
Java 8:	Leximi, dëgjimi dhe kuptimi si proces i të nxëniet
Java 9:	Interpretimi i letërsisë në procesin mësimor
Java 10:	Mënyrat e komunikimit mësimdhënës-student
Java 11:	Objektivat që duhet të realizohen gjatë procesit mësimor
Java 12:	Metodat, materialet dhe mjetet që duhen zbatuar në lëndën e didaktikës së



	letërsisë
Java 13:	Mësim ndërveprues në orët e letërsisë
Java 14:	Mësim ndërveprues në orët e letërsisë
Java 15:	Këshillat praktike për mësimdhënie

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët duhet të vijnë me kohë në auditor, sepse ardhja me vonesë sjell ndërprerjen e mësimit dhe pengon, çrregullon e shpërçendron vëmendjen e studentëve. Gjatë orës së mësimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike, sepse shkaktojnë zhurmë ose pengesa të tjera.

## **Silabus i lëndës *Metodat në mësimdhënien e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj***

Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Metodat në mësimdhënien e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	Viti V, Semestri IX
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc.Dr. Milote Sadiku
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:milote.sadiku@uni-pr.edu">milote.sadiku@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është q' i njoftojë studentët me parimet themelore të mësimdhënies së gjuhës gjermane si gjuhë e huaj (DaF) dhe me metoda të ndryshme që nxisin zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave gjuhësore. Kjo lëndë po ashtu synon t' u ndihmojë studentëve që të kenë një fillim më të lehtë në mësimdhënie si mësues të gjuhës gjermane. Këtu do të sqarohen bazat e DaF-mësimdhënies: didaktizimi i katër shkathtësive gjuhësore, si të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit; kompetencat themelore, si leksiku, gramatika, fonetika; ndërveprimi në mësim; format sociale; strategjitë dhe autonomia e nxënësve; planifikimi i orës mësimore; përgatitja e testeve.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kësaj lënde janë: <ul style="list-style-type: none"><li>- që studentët të marrin njohuritë e nevojshme praktike për mësimdhënien e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj,</li><li>- që studentët të përdorin metoda atraktive që nxisin zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave gjuhësore,</li><li>- që t' u ndihmojë studentëve që të kenë një fillim më të lehtë në mësimdhënie si mësues të gjuhës gjermane,</li><li>- që t' i aftësojë studentët që të bëjnë didaktizimin e shkathtësive gjuhësore dhe të kompetencave themelore,</li><li>- që t' i aftësojë studentët që të planifikojnë orët mësimore.</li></ul>

**Rezultatet e pritshme të nxënies:**

Pas përfundimit të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje:

- të përdorin metoda të ndryshme dhe atraktive që nxisin zhvillimin e shkathtësisë së të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit,
- të demonstrojnë njohuri për format sociale në mësimdhënien e gjuhës së huaj,
- të demonstrojnë njohuri për përpilimin e testeve,
- që të planifikojnë orët e tyre mësimore.

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediary			
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	5	2	10
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	6	2	12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.	30 min	1	0.5
<b>Total</b>			<b>93.5</b> <b>93.5:25 =</b> <b>3.74</b> <b>4 ECTS</b>

**Metodat e mësimdhënies:**

Mësimi është interaktiv. Studentët duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë dhe të jenë bashkëpunues, pasi që do të diskutohet për metodat e ndryshme adekuatë për zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave gjuhësore. Studentët do të zgjedhin secili nga një metodë për të bërë prezantimin e shkathtësive dhe kompetencave gjuhësore.

Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Aktiviteti i studentit në klasë 10% Prezantimi në klasë 40% Punimi seminarik i prezantimit 50%
Literatura primare:	1. Bimmel, Peter/Kast, Bernd/Neuner, Gerd (2017): <i>Deutschunterricht planen. Arbeit mit Lehrwerklektionen</i> . Fernstudieneinheit 18. 2. Brinitzer, Michaela et al. (2013): <i>DaF unterrichten: Basiswissen Didaktik Deutsch als Fremd- und Zweitsprache</i> . Stuttgart.
Literatura shitesë:	1. Bredel, Ursula/ Pieper, Irene (2015): <i>Integrativer Deutschunterricht</i> . 2. Becker, Georg E.: <i>Unterricht planen. Handlungsorientierte Didaktik</i> , Teil I. Weinheim, Basel, Berlin 2004 3. Hoffmann, Bernhard (2015): <i>Der Unterrichtsentwurf. Leitfaden und Praxishilfe</i> . Baltmannsweiler. 4. Huneke/Steinig (2013): <i>Deutsch als Fremdsprache. Eine Einführung</i> . Berlin.

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Fertigkeit Sprechen
Java 2:	Vermittlung der Fertigkeit Sprechen: Sprechaktivitäten entwickeln
Java 3:	Fertigkeit Hören
Java 4:	Phasen des Hörverstehens
Java 5:	Vermittlung der Fertigkeit Sprechen
Java 6:	Fertigkeit Schreiben Phasen des Schreibprozesses
Java 7:	Vermittlung der Fertigkeit Schreiben: Methoden zur Förderung des Schreibprozesses
Java 8:	Fertigkeit Lesen Vorentlastung und Vorbereitung des Leseverstehens
Java 9:	Fertigkeit Lesen: Leseaktivitäten
Java 10:	Landeskunde im Unterricht
Java 11:	Interkulturelles Lernen im Unterricht
Java 12:	Interaktion im Unterricht: Sozialformen, Übungen und Aufgaben

Java 13:	Heterogene Lerngruppen
Java 14:	Unterrichtsplanung
Java 15:	Unterrichtsplanung

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën në heshtje për të marrë shënime; aktivitete të tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi. Nga të gjithë pritet të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve gjatë diskutimeve, dhe nuk bënë të përdorët gjuhë e pahijshme. Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit.

## SEMESTRI I DHJETË

### LËNDËT MËSIMORE – TË OBLIGUESHME

#### Silabus i lëndës Pragmatikë

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Pragmatikë
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i V-të, semestri i X-të
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Vjosa Hamiti
Të dhënat kontaktuese:	vjosa.hamiti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Në këtë lëndë do të bëhet një hyrje në pragmatikë, ku në krahasim me semantikën nuk do të shihet vetëm kuptimi i fjalës, por përdorimi i saj në kontekst. Do të merren parasysh ndërveprimet në mes të një thënieje dhe kontekstit, si dhe të asaj se çfarë qëllimi përmbush ajo. Pra, këtu nuk analizohet fjala ose fjalia pa situatë. Këtu rëndësinë kryesore e ka thënia. Fjalitë shihen si njësi që ndahen në propozicion dhe ilokucion. Por, fjalia mund të mos e ndërtojë një thënie, atëherë dalim edhe jashtë fjalisë, ku disa fjali mund të paraqesin një thënie. Temat kryesore që do të shtjellohen janë: referenca, deiktikët, implikimet, paragjykimet, aktet e të folurit, si dhe theksimi i strukturës informative nëpërmjet të rendit të fjalëve në fjali dhe intonacionit. Në aspektin funksional-komunikativ lidhjet ndërmjet folësit dhe marrësit mund të jenë me funksion informues, obligues, thirrës, kontaktues dhe deklarues. Në

	pragmatikën tekstore rol të rëndësishëm luajnë edhe standardet e tekstualitetit.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> <li>informimi i studentëve me nocionet kryesore dhe çështje të ndryshme të hulumtuara në pragmatikë;</li> <li>informimi i studentëve me ndërveprimet në mes të një te teksti dhe kontekstit;</li> <li>shpjegimi i aspekteve funksionale ndërmjet folësit dhe marrësit;</li> <li>të njoftohen studentët se si ndërveprimi ndërkulturor mund të ndikojë në komunikimin tej kulturor dhe në mësimdhënien e gjuhës së dytë.</li> </ul>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> <li>t'i identifikojë dhe t'i shpjegojë nocione kryesore dhe çështje të ndryshme të hulumtuara në pragmatikë;</li> <li>të shpjegojë dhe të ilustrojë se si nocionet pragmatike si: paragjykimet apo implikimet mund të dallohen gjatë procesit të komunikimit;</li> <li>të shpjegojë se si ndërveprimi ndërkulturor mund të ndikojë në komunikimin tej kulturor dhe në mësimdhënien e gjuhës së dytë;</li> <li>Të jete ne gjendje të shkruaj një punim seminari nga fusha e pragmatikës.</li> </ul>

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2 (45 min)	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1 (45 min)	15	11.25
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	15 min.	15	4
Puna në terren			

Testi, punimi i seminarit	2 (45 min)	15	22.5
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2 (60 min)	15	30
Përgatitja për provimin final	6 (60 min)	4	24
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2 (60 min)	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	2	1	2
<b>Total</b>			<b>150.25 orë: 25 = 6.01 6 ECTS</b>
<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Lënda përbëhet nga 2 orë ligjërata në javë, ku do të jepet baza teorike. Mirëpo, mësimi mbahet edhe në formë interaktive. Vend do t'i jipet edhe prezantimeve të punimeve seminarike dhe diskutimeve për to, studentët janë të obliguar të marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë dhe të zhvillojnë diskutime me kolegët.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	a) Punimi seminarik: 30% b) Prezantimi me gojë: 10% c) Provimi final: 55% d) vijimi i rregullt 5%		
<b>Literatura primare:</b>	<b>Ligjerata:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Liedtke, Frank/ Tuchen, Astrid (2018): Handbuch Pragmatik. Stuttgart: J.B. Metzler</li> <li>Finkbeiner, Rita.2015. Einführung in die Pragmatik. Hemsbach: WBG.</li> <li>Rolf, Erhardt. 2013. Pragmatik: Implikaturen und Sprechakte. Wiesbaden</li> <li>Erhardt, Claus / Heringer, Hans Jürgen. 2011. Pragmatik. Stuttgart: Wilhelm Fink UTB.</li> <li>Meibauer, Jörg. 2008. Pragmatik. Eine Einführung. Tübingen: Staffenburg .</li> <li>Ernst, Peter (2002): Pragmalinguistik : Grundlagen, Anwendungen, Probleme. Berlin, New York: De Gruyter,</li> </ol>		



Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Betty J. Birner (2012) Introduction to Pragmatics. Vol. 38. John Wiley &amp; Sons.</li> <li>2. Stephen C. Levinson (1983). Pragmatics. Cambridge Textbooks in Linguistics. Cambridge University Press, 1983.</li> <li>3. Steven Davis (1991): Pragmatics: A Reader. Oxford University Press, 1991.</li> <li>4. Meibauer et.al. (2015). Einführung in die germanistische Linguistik. Stuttgart/Weimar</li> <li>5. Ernst, Peter (2004): Germanistische Sprachwissenschaft. Wien</li> <li>6. Rolf von Schmidt, Eckard (2013): Inferentielle Pragmatik: Zur Theorie der Sprecher-Bedeutung. Berlin</li> </ol>
---------------------	---

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Einführung in der Lehrveranstaltung
Java 2:	Bedeutungs- und Inhaltsaspekte in der Pragmatik
Java 3:	Pragmatische Zeichentheorie
Java 4:	Deixis
Java 5:	Anaphern
Java 6:	Referenz
Java 7:	Implikatur
Java 8:	Präsupposition
Java 9:	Sprechakttheorie
Java 10:	Indirektheit
Java 11:	Konversationsstruktur, Informationsstruktur
Java 12:	Anwendungsgebiete der Pragmatik: Gesprächsanalyse
Java 13:	Anwendungsgebiete der Pragmatik: Kontrastive und <b>Interkulturelle</b> Pragmatik
Java 14:	Anwendungsgebiete der Pragmatik: Experimentelle Pragmatik
Java 15:	Zusammenfassung und Ausblick

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.

## **Silabus i lëndës *Letërsia e krahasuar***

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	<b><i>Letërsia e krahasuar</i></b>
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Obl.
Viti i studimeve:	viti i V-të, semestri i 10-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.asoc.dr. Naser Mrasori
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:Naser.Mrasori@uni-pr.edu">Naser.Mrasori@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda “Letërsi e krahasuar” si fushë e re studimi, është një domosdoshmëri e kohës, e cila ka shërbyer dhe shërben si urë ndërlidhëse mes letërsive dhe kulturave të ndryshme, dhe sot shumë shpesh quhet edhe si shkencë e analogjive dhe ndikimeve ndërletrare. Letërsia e krahasuar është disiplinë shkencore e cila studion dukuritë letrare gjatë raporteve të ndërsjella por edhe me fenomenet joletrare. Emri rrjedh nga latinishtja: comparare që to të thotë krahasoj.</p> <p>Kjo lëndë ka për synim analizën dhe përshkrimin në nivelin universitar, të shumë çështjeve bazë të letërsisë së krahasuar, si qëllim të studimit të letërsisë. Përmes studimit, krahasimit dhe analizave, do të jepen karakteristikat specifike të kësaj fushe. Përmes shembujve konkret, të krijimtarive që u takojnë gjuhëve dhe kulturave të ndryshme, atyre që i përkasin të njëjtës trevë gjuhësore dhe kulturore, paraqiten teoritikisht dhe praktikisht gjatë zhvillimit të kësaj lënde. Në pjesën përfundimare të lëndës trajtohen çështjet themelore të një poetike krahasuese.</p>

<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Lënda “Letërsi e krahasuar” synon që studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihet në përgjithësi me o objektin e studimit të letërsisë së krahasuar, letërsinë kombëtare dhe atë botërore;</li> <li>• me studimin e çdo objekti të quajtur letrar, duk e vënë në marrëdhënie me elementët e tjerë përbërës të një kulture.</li> <li>• të njihet me konceptet dhe me metodologjitë e letërsisë së krahasuar</li> <li>• me definicionet e letërsisë së krahasuar;</li> <li>• me nocionet e përgjithshme të letërsisë së krahasuar;</li> <li>• shkollat e letërsisë se krahasuar si psh. Franceze, amerikane , gjermane, etj.</li> <li>• të njihet me artin metodik nëpërmjet kërkimit të lidhjeve analogjike, të afrisë dhe te ndikimit;</li> <li>• me ndikimet ndërletrare</li> <li>• me zhvillimin e temave dhe formave të letërsisë së krahasuar;</li> <li>• me dallimin dhe perkufizimin e letërsisë krahasuese;</li> <li>• me zgjedhjen e veprave letrare - krahasuese;</li> <li>• me fushat semantike dhe konotacionet e termave;</li> <li>• me historinë dhe zhvillimin e saj në periudha të ndryshme kohore;</li> <li>• me teoritë e përkthimit dhe stilistikën e krahasuar dhe</li> <li>• shkollat dhe metodat e letërsisë</li> </ul>
<p>Rezultatet e pritshme të nxënies:</p>	<p>Pas mbarimit të kursit, studenti duhet të ketë njohuri të mjaftueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për objektin e studimit të letërsisë krahasuese;</li> <li>• për metodologjitë e studimit të letërsisë së krahasuar;</li> <li>• për rolin dhe rendësinë e letërsisë krahasuese;</li> <li>• për ndikimet ndërletrare;</li> <li>• për detyrat dhe qëllimet e studimit të letërsisë së krahasuar;</li> <li>• për rolin dhe kontributin e përkthimit në zhvillimin e letërsisë së krahasuar;</li> <li>• të jenë në gjendje të dallojnë dhe të shpjegojnë raste konkrete të ndikimeve, analogjive, përafrive në letërsinë origjinale dhe në atë të përkthyer.</li> </ul>

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Konsultimet	10 min	15	2.5
Kollokviume / Seminare	7	4	28

Detyra të shtëpisë	3	15	45
Koha e studimit vetanak(bibliotekë, shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (test, provim)	2	2	4
Projekte, prezantime	30	1	0.5
Seminare, kollokviume	1	1	10
<b>Total</b>			<b>162.5:25 = 6.5 6 ECTS</b>

**Metodat e mësimdhënies:** Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me shpjegime përkatëse. Gjatë shpjegimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Lexohen dhe analizohen vepra që kanë shembuj konkret të ndikimeve, ngjajshmerive, analogjive në letërsi .Në fillim të ligjeratës gjithmonë zhvillohet debat për leksionin paraprak.Në vazhdim me temat e radhës dhe në fund të ligjeratës bëhet një përsëritje e përbashkët e leksionit të posa zhvilluar.

**Metodat e vlerësimit:** Vlerësimi është paraparë të bëhet mbështetur në statutin e Universitetit të Prishtinës ( provimi me shkrim dhe me gojë), dhe duke pasur parasyshë edhe punën dhe angazhimin e studentëve gjatë vitit akademik si psh. Pjesëmarrja, anazhimi, punimet seminarike, testet, referimet, diskutimet etj.

**Literatura bazë:**

- Angelika COBINEAU: Einfuehrung in die Komparatistik.2 ueberarbeite und erweiterte Auflage.
- Erich Schmidt, Berlinn 2004, ISBN 3-503-07909-2
- Ernst Grabowzski: Vergleichende Literaturwissenschaft fuer Einsteiger.Boehlau/UTB,Wien/Stuttgart 2011,ISBN 978-3-8252-3565-9.
- Manfred Schmeling(Hrsg):Vergleichende Literaturwissenschaft.Teori und Praxis.Athenaion,Wiesbaden 1981,ISBN 3-7997-0764-6
- Yves Chevrel: Letërsia e krahasuar. Albin, Tirane 2002.
- Umberto Eco, *Për letërsinë*, Tiranë, 2007
- Rene Velek, Ostin Voren, Teoria e letërsisë, Prishtinë, 198
- Ernst Grabowzski: Vergleichende Li.wissenschaft für Einsteiger.
- Evi Zemanek, Alexander Nebrig (Hg.)Komparatistik.Akademie Verlag, Berlin, 2012,
- H.Brackert, J.Stückrath. Literaturwissenschaft. 2001.
- Rüdiger Zymner und Achim Hölter. Handbuch Komparatistik. Theorien, Arbeitsfelder, Wissenspraxis. 2013 Springer-Verlag GmbH Deutschland

--	--

<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Jordan, L./Kortländer, B. (Hgg.) 1995: Nationale Grenzen und internationaler Austausch. Studien zum Kultur- und Wissenschaftstransfer in Europa. Narr, Tübingen, 1995.</li> <li>- Naser Mrasori. Kur Stefan Cvajg na flet shqip. Rozafa, Prishtinë, 2008.</li> <li>- Naim Kryeziu. Hajnrih Hajne poet i lirisë dhe i dashurisë. Rozafa, Prishtinë, 2012.</li> <li>- M. de Matteis, B. Kadzadej, J. Röhling, (Hg). Interkulturalität und Landeswissenschaft. Athena, 2010, Oberhausen.</li> <li>- Osman Gashi, Studime interliterare, Prishtinë, 2001</li> </ul>
---------------------------	--

<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
---------------------------------	--

<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë</b>	Përkufizimet e letërsisë së krahasuar: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Letërsia e përgjithshme</li> <li>- Letërsia kombëtare</li> <li>- Letërsia botërore</li> <li>- Letërsia si shkencë</li> <li>- Letërsia e krahasuar etj.</li> </ul>
<b>Java e dytë</b>	<b>Hyrje në letërsinë e krahasuar:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zanafilla dhe zhvillimi i letërsisë së krahasuar</li> <li>- Roli dhe rëndësia e saj</li> <li>- Metodrat dhe fushat e studimit</li> </ul>
<b>Java e tretë</b>	<b>Shkenca e përkthimit dhe teoritë e përkthimit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkthimi letrar apo rikrijimi</li> <li>- Problemet e kalimit nga një gjuhë në një tjetër</li> <li>- Teoritë moderne</li> </ul>
<b>Java e katërt</b>	<b>Përkthimi letrar në letërsinë e krahasuar:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Roli dhe rëndësia e përkthimit dhe përkthyesve në lindjen dhe zhvillimin</li> </ul>

	<p>e letërsisë së krahasuar</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkthyesi si ndërmjetës</li> <li>- Përkthimi si bartës i vlerave kulturore</li> <li>- Përkthimi i letërsisë gjermane në shqip</li> </ul>
<b>Java e pestë</b>	<p><b>Letërsia kombëtare dhe letërsia e huaj</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lidhjet mes letërsive</li> <li>- Ndikimet e autoreve të mëdhenj në letërsitë e ndryshme botërore</li> <li>- Ndikim, analogji apo ngjashmëri</li> <li>- Ndikimi i veprave letrare në shoqëri.</li> </ul>
<b>Java e gjashtë</b>	<p><b>Shkëmbimet dhe ndikimet nga letërsitë huaja në letërsinë kombëtare</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndikimet gjuhësore</li> <li>- ndikimet kulturore, historike dhe ideologjike</li> </ul>
<b>Java e shtatë</b>	<p><b>Miti në letërsi;</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Receptimi i miteve</li> <li>- Miti dhe mitologjia</li> <li>- Mitologjia e krahasuar, studimet mbi mitet letrare</li> </ul>
<b>Java e tetë</b>	<p><b>Sistemi i pritjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hermeneutika</li> <li>- Jehona e veprës së përkthyer</li> <li>- vlerësimet kritiko-letrare</li> </ul>
<b>Java e nëntë</b>	<p><b>Receptimi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Historia e receptimit</li> <li>- Estetika e receptimit</li> <li>- Mënyra e përhapjes i veprës së përkthyer letrare</li> <li>- Lexuesit dhe pranimi nga ana e lexuesit</li> </ul>
<b>Java e dhjetë</b>	<p><b>Receptimi letrar:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndikimi, jehona, përhapja</li> <li>- Mënyra e bartjes dhe ndërmjetësimi</li> </ul>
<b>Java e njëmbëdhjetë</b>	<p><b>Letërsia shumë-gjuhësore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Letërsia në vendet shumëgjuhësore dhe ato me migracion të madh</li> <li>- Ndikimet moderne dhe llojet e ndikimit</li> <li>- Shumëllojshmëria e ndikimit</li> </ul>
<b>Java e dymbëdhjetë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Intermedialiteti (Letërsi/Film, Letërsi/Fotografi, Letërsi/Muzikë, Letërsi/Media etj.</li> <li>- Interkulturaliteti (kontaktet kulturore, dialogu ndërkulturor, filozofia, religjioni, shoqëria, politika etj)</li> </ul>
<b>Java e trembëdhjetë</b>	<p><b>Epokat, rrymat, lëvizjet dhe grupet letrare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi i rrymave letrare</li> <li>- Marrëdhëniet e rrymave</li> </ul>

	- Themelet e shqyrtimit metodologjik dhe kritik të tyre
<b>Java e katërbëdhjetë</b>	<b>Krahasimi në letërsi</b> - Krahasimi si shkencë - Krahasimi si metodë - Metodrat dhe tipet e krahasimit
<b>Java e pesëmbëdhjetë</b>	<b>Shkollat dhe metodat e studimit të letërsisë</b> - shkolla francize – strukturalizmi dhe post-strukturalizmi - shkolla amerikane - te amerikanët dominoi Kritika e Re - shkolla gjermane - te gjermanët ishte dominuese metoda e vëzhgimit të letërsisë si sferë e zhvillimit të shpirtit njerëzor. - shkolla ruse - te rusët dominoi formalizmi.  - Sipas M. Maren – Erizebah dallon: metodën pozitiviste, fenomenologjike, ekzistencialiste, morfologjike, sociologjike. - Grupi i autorëve J. Hauf, A. Heler, B. Hipauf, L. Ken dhe K.P. Flipia dallojnë: metodën pozitiviste, formaliste-strukturaliste, hermeneutike dhe marksiste. - M. Korti dhe Ç. Segre numërojnë tetë metoda: sociologjike, simboliste, psikanalitike, stilistike, historike dhe stilistiko kritike, formaliste, strukturaliste dhe semiologjike.

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Përmes këtij kursi studentët thellojnë dijet në këtë fushë duke qenë aktiv në pjesëmarrje, të angazhuar gjatë ligjëratave dhe në punët seminarike. Vijueshmëria e rregullt u ndihmon që ata të kenë më shumë të dhëna në përkufizimet e kësaj fushe, fenomenet e letërsisë së krahasuar, ndikimet dhe komunikimet ndërkulturore, përkthimet letrare, receptimi dhe përhapja e veprës së përkthyer, prandaj ata duhet të vijnë me kohë dhe të motivuar dhe të përgatitur në auditor, mosardhja e rregullt dhe me kohë, sjell ndërprerjen e mësimnxënies dhe i shkakton ndërprerje të marrjes së informacioneve të duhura për përgaditjen e lëndës letërsie krahasuar.



## Silabus për Punimi i Diplomës MA

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Punimi i Diplomës MA
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i V-të, semestri i 10-të
Numri i orëve në javë:	
Kreditë ECTS:	10
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Pas përfundimit të provimeve të parapara në programin MA Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, studentët duhet ta hartojnë punimin e diplomës (MA). Ata përzgjedhin një temë nga lëmi i gjuhësisë, i letërsisë apo i metodikës së gjermanishtes si gjuhë e huaj. Temat e zgjedhura trajtohen në aspektin teorik, empirik apo praktik. Ky punim duhet të dëshmojë se studenti është i aftë ta shqyrtojë një temë në mënyrë të pavarur si për nga përmbajtja ashtu edhe nga ana metodike. Punimi duhet të hartohet duke respektuar rregullat e një punimi shkencor dhe në përputhje me rregulloret dhe Statutin e UP-së.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të provimeve dhe përfundimi të tezës MA, pritet që studenti të jetë në gjendje:</p> <p>Të njohurit dhe të kuptuarit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aftësia për të planifikuar, kryer dhe vlerësuar hulumtimin me të avancuar në fushën e gjuhësisë, letërsisë gjermane ose të mësimdhënies</li> <li>- Të shkruarit e teksteve shkencore në nivelin me të avancuar,</li> </ul> <p>Kompetenca kyçe/të përgjithshme me të avancuar:</p>

- Kompetencë e të shkruarit
- Vlerësim kritik dhe shfrytëzimi i burimeve
- Sqarim në detaje i rezultateve
- Përdorimin e teknologjisë informative.

### Ngarkesa e studentit

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat			
Konsultime me mësimdhënësin	1	15	15
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	15	15	225
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	10	4	50
Përgatitja për provimin final	4	1	4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			
Projektet, prezantimet, etj.			
<b>Total</b>			<b>294: 25=11.76 10 ECTS</b>

#### Metodologjia e mësimdhënies:

Punë e pavarur e kryer nën udhëheqjen e mentorit.

#### Metodat e vlerësimit:

Diploma (MA)  
Prezantimi i Diplomës: para komisionit

#### Literatura bazë:

1. Eco, Umberto (2005) *Wie man eine wissenschaftliche Abschlußarbeit schreibt*.
2. Pospiech, Ulrike. (2005) *Duden Ratgeber - Wie schreibt man wissenschaftliche Arbeiten?: Alles Wichtige von der Planung bis zum fertigen Text*. Mannheim.
3. Grätz, Frank. (2006) *Duden. Wie verfasst man wissenschaftliche Arbeiten?: Ein Leitfaden für das Studium und die Promotion*.
4. Trapp, Sebastian. (2007) *Wie man tatsächlich eine wissenschaftliche Arbeit schreibt: Daten, Schreibtechnik, Zeitplanung, Veröffentlichung - in der realen Welt*.

Studentët e zgjedhin literaturën shkencore varësisht nga fusha e tyre e punës në diplomë.

## Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Punimi i diplomës master punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore. Plagjiatura nuk tolerohet dhe ndëshkohet sipas rregulloreve të UP-së.

# LËNDËT MËSIMORE – ME ZGJEDHJE

## Silabus i lëndës *Sintaksë gjenerative*

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Sintaksë gjenerative
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	viti i V-të, semestri i 10-të
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. dr. Teuta Abrashi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:teuta.abrashi@uni-pr.edu">teuta.abrashi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Hulumtimet kognitive kanë dëshmuar se secili fëmijë lind me një gramatikë të brendshme universale e cila është pjesë konstitutive e sistemit mental njerëzor, prandaj të gjitha gjuhët janë të ndërtuara mbi parime të njëjta, ato dallohen për nga parametrat specifik të cilët secila gjuhë i ka. Struktura gjegjësisht sintaksa është njëri nga këto parametra. Në këtë lëndë mësimore do të shtjellohen parimet themelore universale gjuhësore dhe specifikat dhe parametrat e gjuhës gjermane krahasuar me gjuhët e tjera. Sintaksa gjenerative, me mjetet e saja apostafat të zhvilluara për të bërë një analizë të tillë është shumë e përshtatshme për të bërë hulumtime shkencore në fushën e gjuhësisë dhe disiplinave të tjera të cilat ndërlidhen me këtë shkencë.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"><li>- t'i njoftojë studentët me parimet themelore të kësaj disipline</li><li>- t'i vetëdijësojë studentët me nocionet themelore të gjenerativizmit si teori</li><li>- t'ua mundësojë studentëve lidhjen midis teorisë dhe praktikës</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'ua mundësojë të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për sintaksën gjenerative e gjuhës gjermane</li> </ul>		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i identifikojë dhe t'i shpjegojë nocionet dhe termat që kanë të bëjnë me sintaksën gjenerative</li> </ul>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i shpjegojë dhe t'i ilustrojë nocionet themelore të gjenerativizmit si teori dhe të përpiqet t'i zbatojë në shembuj konkretë nga gjuha gjermane</li> </ul>		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- ta bëjë një sintezë të sintaksës gjenerative nga fillimet e saj e deri në ditët e sotme duke e ilustruar konkretisht</li> </ul>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë mësimore</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjëratat	2	15	22,5
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2,30
Testi, punimi i seminarit	1	2	2
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	4	7	28
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Total</b>			<b>104,8:25=4.19 4 ECTS</b>
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike, përgatitjes dhe prezantimit të punimeve seminarike dhe detyrave të vazhdueshme në shtëpi.		

Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punimi seminarik 30%</li> <li>• Pjesëmarrja 10%</li> <li>• Provimi 60%</li> </ul> <p><b>Provimi:</b> Kusht për provim është punimi seminarik. Provim përmbledhës në afatin e provimeve. Provimi është vetëm me shkrim.</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Philippi, Jule/Tewes, Michael (2010): Basiswissen Generative Grammatik.UTB Vandenhoeck&amp;Ruprecht, Göttingen</li> <li>2. Klenk, Ursula (2003): Generative Syntax, Günthe Narr Vrlag, Tübingen</li> <li>3. Fanselow, Gisbert/Sascha W. Felix (1993): Sprachtheorie 2-Die Rektions-und Bindungstheorie, UTB, Tübingen</li> <li>4. Fanselow, Gisbert/Sascha W. Felix (1993): Sprachtheorie 1-Grundlagen und Zielsetzung, UTB, Tübingen</li> <li>5. Gallman, Peter (1990): Kategoriell komplette Wortformen-Das Zusammenwirken von Morphologie und Syntax bei der Flexion von Nomen und Adjektiv, Max Niemeyer Verlag, Tübingen</li> <li>6. Grewendorf, Günther (2002): Minimalistische Syntax. UTB, A. Francke Verlag, Tübingen / Basel</li> <li>7. Klenk, U. (2003). Generative Syntax: 1. Konstituentenstrukturen. In: Hoffmann, Ludger (Hrsg.) Sprachwissenschaft (2010), Walter de Gruyter, Berlin/New York</li> <li>8. Chomsky, Noam (1988/1996): Probleme sprachlichen Wissens: Prinzipien der Sprachstruktur. In: Hoffmann, Ludger (Hrsg.) Sprachwissenschaft (2010), Walter de Gruyter, Berlin/New York</li> <li>9. Linke, Angelika/Nussbaumer, Markus / Portmann, Paul, R. (1991).Studienbuch Linguistik. Niemeyer, Tübingen</li> </ol>
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Busch,A./Stenschke,O.(2007): Germanistische Linguistik, Tübingen: Narr Franke (S.75-114)</li> <li>2. Duden- Grammatik (2005)Bd.4 Mannheim</li> <li>3. Engel U (2004): Deutsche Grammatik, München</li> <li>4. Meibauer, J. (et.all) (2002): Einführung in die germanistische Linguistik, Stuttgart: Metzler (S.15-67)</li> <li>5. Vater, H. (1996): Einführung in die Sprachwissenschaft, München: Fink (S.68-103)</li> </ol>
<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
Java	Titulli i ligjëratisë
Java 1:	Hyrje, çështë gramatika gjenerative, gramatika universale

Java 2:	Strukturat e konstituentëve I (koncepti i sintaksës, fjalitë dhe konstituentët, testi i konstituentëve)
Java 3:	Strukturat e konstituentëve II (klasifikimi i konstituentëve, leksikoni, llojet e fjalëve, subkategorizimi)
Java 4:	Leksikoni, llojet e fjalëve, subkategorizimi
Java 5:	Strukturat e konstituentëve III ( Predikati dhe argumentët e tij, teoria theta, parimi i projekcionit)
Java 6:	Struktura X-Bar (kategoritë leksiokore, VP, NP, AP,
Java 7:	Frazat funksionale (DP, IP, CP, TP etj.)
Java 8:	Teoria e rasës (rasa strukturore dhe leksikore, rasa morfologjike dhe abstrakte)
Java 9:	Teoria e lidhjeve
Java 10:	Teoria e kontrollës dhe modulet e tjera të teorisë së principeve dhe parametrave
Java 11:	Programi minimalist
Java 12:	Strukturat sintaksore të gjuhës gjermane I (struktura e frazës Verbale)
Java 13:	Strukturat sintaksore të gjuhës gjermane I (struktura e frazës Nominale)
Java 14:	Strukturat sintaksore të gjuhës gjermane II (struktura e frazës prepozicionale)
Java 15:	Strukturat sintaksore të gjuhës gjermane III (struktura e fjalisë)

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat, nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.

## Silabus i lëndës *Modelet gramatikore*

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Modelet gramatikore
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	viti i V-të, semestri i 10-të
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. dr. Teuta Abrashi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:teuta.abrashi@uni-pr.edu">teuta.abrashi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Në tentimet për të shpjeguar sa më mirë dhe në mënyrë adekuate dukuritë gjuhësore, shkencëtarë, shkolla dhe institucione të ndryshme kanë zhvilluar teori të ndryshme të modeleve gramatikore. Secila prej tyre ka bërë avancime dhe ka arritur rezultate të konsiderueshme. Mirëpo, për të mësuar këto rezultate, për shkak të kompleksitetit të tyre siç janë rregullat, diagramet, formulat etj. është e domosdoshme që një hulumtues i ri shkencor të ketë njohuri themelore rreth këtyre modeleve gramatikore për të deshifruar dhe nxjerrë thelbin e porosive që dalin nga artikuj, libra, kumtesa shkencore etj. Kjo lëndë ka për qëllim të njoftoi studentët me bazat themelore të teorisë së valencës, gramatikës funksionale, gramatikës gjenerative, gramatikës dependenciale, teorisë së optimalitetit dhe teorive të tjera.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i njoftojë studentët me bazat themelore të teorisë së valencës, gramatikës funksionale, gramatikës gjenerative, gramatikës dependenciale, teorisë së optimalitetit dhe teorive të tjera së gjuhës gjermane</li> <li>- t'i vetëdijësojë studentët për të deshifruar</li> </ul>



	<p>dhe nxjerrë thelbin e porosive që dalin nga artikuj, libra, kumtesa shkencore etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- t'ua mundësojë studentëve lidhjen midis teorisë dhe praktikës</li> <li>- t'ua mundësojë të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për modelet gramatikore e gjuhës gjermane</li> </ul>
--	---

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i identifikojë dhe t'i shpjegojë nocionet dhe termat që kanë të bëjnë me modelet gramatikore në përgjithësi</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i diskutojë modelet të ndryshme si: teoria e valencës, funksionale, gramatikës gjenerative, gramatikës dependenciale, teorisë optimalitetit etj.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të krahasojnë teori të ndryshme dhe të inicojnë, kryejnë dhe finalizojnë hulumtim lidhur me temat që trajtohen në këtë lëndë.</li> </ul>

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2,30
Testi, punimi i seminarit	1	2	2
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	4	7	28
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Total</b>			<b>104,8:25=4.19 4 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike, përgatitjes dhe prezantimit të punimeve seminarike dhe detyrave të vazhdueshme në shtëpi.
-------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punimi seminarik 30%</li> <li>• Pjesëmarrja 10%</li> <li>• Provimi 60%</li> </ul> <p><b>Provimi:</b> Kusht për provim është punimi seminarik. Provim përmbledhës në afatin e provimeve. Provimi është vetëm me shkrim.</p>
-----------------------	--

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Jungen, Oliver/Lohnstein, Horst (2006): Einführung in die Grammatiktheorie. UTB, W. Fink Verlag, München</li> <li>2. Müller, Stefan (2010): Grammatiktheorien- Einführngen. Staufenberg Verlag, Tübingen</li> <li>3. Dürscheid, Christa (2010): Syntax-Grundlagen und Theorien, UTB, Göttingen</li> <li>4. Helbig, Gerhard (1989): Geschichte der neueren Sprachwissenschaft, Westdeutscher Verlag, Opladen</li> <li>5. Welke, Klaus (2011): Valenzgrammatik des Deutschen, de Gruyter, Berlin</li> <li>6. Agel, Vilmos (2000): Valenztheorie, Gunther Narr Verlag, Tübingen</li> <li>7. Jungen, Oliver/Lohnstein, Horst (2007): Geschichte der Grammatiktheorie- von Dionysios Thrax bis Noam Chomsky. Wilhelm Fink Verlag, Münch</li> </ol>
---------------------	---

Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>10. Busch,A./Stenschke,O.(2007): Germanistische Linguistik, Tübingen: Narr Franke (S.75-114)</li> <li>11. Duden- Grammatik (2005)Bd.4 Mannheim</li> <li>12. Engel U (2004): Deutsche Grammatik, München</li> <li>13. Meibauer, J. (et.all) (2002): Einführung in die germanistische Linguistik, Stuttgart: Metzler (S.15-67)</li> <li>14. Vater, H. (1996): Einführung in die Sprachwissenschaft, München: Fink (S.68-103)</li> </ol>
---------------------	--

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratis
Java 1:	Hyrje (qëllimi i lëndës, elementet e modeleve gramatikore, zhvillimet e modeleve gramatikore)
Java 2:	Modelet e hershme gramatikore (modeli grek, modeli romak)
Java 3:	Gramatika e vjetër (gramatika logjike, gramatika e përgjithshme, gramatika historike)
Java 4:	Strukturalizmi I (themelimi i strukturalizmit nga Sosuri, shkolla e Pragës, shkolla e Kopenhagenit)
Java 5:	Strukturalizmi II (strukturalizmi në Amerikë)

Java 6:	Gramatika depedenciale dhe Valentore I (depedenca e valenca, argumentet dhe struktura e argumenteve)
Java 7:	Gramatika depedenciale dhe Valentore II (teoria e valences, gramatika e rasës)
Java 8:	Gramatika funksionale (konceptet themelore, struktura informative e fjalisë)
